

BEQIR META**SHKOLLAT E MINORITETIT GREK
NË VITET 1925-1930****Zhvillimi i arsimit në zonën e minoritetit
grek dhe problematikat**

Minoriteti grek ruajti dhe konsolidoi shkollat në gjuhën amtare. Këto shkolla kishin funksionuar gjatë periudhës së Perandorisë Osmane dhe statusi i tyre thuhet mbeti i pandryshuar gjatë më se dy dekadave të ekzistencës së shtetit shqiptar. Me Deklaratën e përfaqësuesit të shtetit shqiptar në Lidhjen e Kombeve, Fan Noli, më 2 tetor 1921¹ këto shkolla fituan një status ndërkombëtar sipas parashikimeve të traktateve të Lidhjes për minoritetet kombëtare. Shteti shqiptar në vitet 1921-1924 i respektoi angazhimet e veta që përcaktoheshin në këtë Deklaratë, madje lejoi që ajo të tejkalohet në disa aspekte nga minoriteti përse i përket funksionimit të shkollave të tij.

Në fillimet e regjimit të ri politik të A. Zogut, shkollat greke funksiononin rregullisht, ashtu si dhe në periudhën e mëparshme. Ekzistonin dy kategori shkollash: shkollat shtetërore ose qeveritare, të cilat financoheshin nga qeveria shqiptare dhe shkollat private, të cilat zyrtarisht thuhej se financoheshin nga popullsia minoritare por, në të vërtetë financoheshin në fshehtësi dhe në kundërshtim me traktatet e Lidhjes së Kombeve si dhe me Deklaratën shqiptare për mbrojtjen e minoriteteve nga qarqet vorio-epirote në Greqi dhe nga qeveria greke. Madje, në kundërshtim me Deklaratën e 2 tetorit 1921, në këto shkolla në shumicën e rasteve nuk po mësohej as gjuha shqipe. Artikulli 6 i Deklaratës së Shqipërisë mbi mbrojtjen e minoriteteve i regjistruar në Lidhjen e Kombeve e obligonte Shqipërinë për t'i akorduar këtij minoriteti lehtësira për mësimin e gjuhës amtare. Por, ky obligim nuk e ndalonte aspak shtetin shqiptar të vendoste në këto shkolla mësimin e

¹ Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi kombëtar në Shqipëri*, Tiranë: Kristalina-KH, 2013, f. 559-560.

gjuhës shqipe si gjuhë e detyrueshme dhe të kërkonte që programi mësimor të mos kishte frymë antishqiptare.

Në gusht 1925, inspektori i Arsimit të Gjirokastrës, njoftonte se “në shkollat greke të Gjirokastrës gjuha shqipe ose nuk jepej fare ose jepet sa për sy e faqe e me tallje”. Autoritetet shqiptare aspironin që gradualisht këtë pakicë ta bënin më luajale ndaj shtetit dhe institucioneve shqiptare dhe të ecnin drejt një “shqiptarizimi” të saj, domethënë drejt adaptimit si shtetas e qytetarë shqiptarë por ndeshnin në shumë vështirësi për të realizuar këtë synim. Njëkohësisht ato konstatojnë se gjendja po evoluonte në drejtim të kundërt. Kështu, në raportin e lartpërmendur thuhej se, në vend që kjo prefekturë, e cila kishte një popullsi të konsiderueshme grekofone, “të merrte nëpërmjet zhvillimit të arsimit kombëtar një fytyrë tjetër, një fytyrë kombëtare, siç i takon një shteti të gjallë e të lirë, përkundrazi ishte ruajtur fytyra e greqizms në fuqi katrore”². Madje, tek autoritetet shtetërore ekzistonte një shqetësim i madh lidhur me përpjekjet që po bëheshin për futjen e gjuhës greke në shkollat e katundeve shqipfolëse nën maskën e fesë³.

Nga burimet dokumentare shqiptare rezulton se tendenca kryesore në vitin 1925 nuk ishte kufizimi i lirive e të drejtave të minoritetit grek, por tendenca e zgjerimit të influencës greke në zonat përreth. Kështu, Këshilli i Ministrave vendosi hapjen e një shkolle greke në Sarandë, në të cilën do të mësonin fëmijët e grekofonëve të këtij qyteti⁴, megjithëse më parë këtu nuk kishte pasur një shkollë të tillë. Ky vendim u kundërshtua nga pjesa më e madhe e popullsisë së Sarandës, e cila kërkonte që në atë qytet të mos hapej shkollë greke⁵. Mirëpo, as grekofonët e Sarandës nuk u mjaftuan me këtë lëshim. Ata kërkuan me ngulm që edhe në shkollat shqipe t’u mësohej nxënësve ortodoksë, feja në gjuhën greke⁶. Në këtë

² Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), viti (më tej: V.) 1925, dosja (më tej: D.) 207, fl.1-2. Relacion i inspektorit të Arsimit-Gjirokastrë, Jani Minga, dërguar prefekturës Gjirokastrë, 17 gusht 1925.

³ Po aty.

⁴ Po aty, F. Ministria e Arsimit (MA), V. 1925, D. 12, fl. 47. Vendim i Këshillit të Ministrave, nr. 425, 15 dhjetor 1926.

⁵ Po aty, fl. 51. Kërkesë e banorëve të Sarandës drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 16 dhjetor 1926.

⁶ Po aty, fl. 47.

situatë edhe dy katunde me popullsi vllahe, Biovizhdë dhe Vllahopsilloterë të nënprefekturës së Përmetit kishin emëruar dy mësues të gjuhës greke, duke ua paguar vetë rrogën. Por, meqë nuk kishin marrë leje për çeljen e shkollës, autoritetet e nënprefekturës e ndaluan përkohësisht funksionimin e saj⁷. Pas vitit 1926, si rezultat i konsolidimit të shtetit dhe regjimit politik të A. Zogut, tendencat për të zgjeruar mësimdhënien në gjuhën greke përtej zonës së minoritetit u fashitën, ndonëse përpjekjet në këtë drejtim nuk reshtën.

Dhënia e gjuhës shqipe në shkollat private, siç e kërkonin ligjet për shkollat e minoriteteve, nuk bëhej pasi mungonte, si interesimi, ashtu edhe mësuesit. Shumica e mësuesve të atij qarku që merrnin rrogë nga shteti shqiptar, nuk dinin të flisnin shqip dhe nuk ishin në gjendje t'u mësonin nxënësve gjuhën shqipe⁸. Kështu, në katundet grekofone të nënprefekturës së Çamërisë në vitin 1927, ishin çelur 12 shkolla private në gjuhën greke. Leja ishte dhënë me kusht që ato do t'u mësonin nxënësve edhe gjuhën shqipe, por mësuesit e këtyre shkollave nuk dinin asnjë fjalë shqip. Përveç kësaj, ata po bënë një propagandë të fshehtë në katundet shqiptare përreth, si Mursia, për të tërhequr disa nxënës në shkollat greke⁹. Autoritetet, pasi e diktuan këtë veprim, i gjobitën prindërit e këtyre nxënësve dhe ata u rikthyen në shkollat shqiptare të katundeve të tyre¹⁰.

Refuzimi për dhënien e gjuhës shqipe në shkollat private greke shkaktoi debate midis administratës lokale shtetërore shqiptare dhe pleqësive të fshatrave greke. Nënprefektura e Libohovës propozoi që, mësuesit e shkollave private grekofone të jepnin në këto shkolla vetëm mësimin e fesë meqë nuk dinin gjuhën shqipe dhe katundet të detyroheshin të emëronin mësues të tjerë që dinin edhe gjuhën shqipe¹¹.

⁷ *Po aty*, F. MPB, V. 1926, D. 108, fl. 16. Prefektura e Gjirokastrës dërguar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 21 shkurt 1926.

⁸ *Po aty*, F. MPB, V. 1927, D. 159, fl. 1. Nënprefektura e Libohovës dërguar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 10 janar 1927.

⁹ *Po aty*, fl. 7. Nënprefektura e Çamërisë dërguar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 7 prill 1927.

¹⁰ *Po aty*.

¹¹ *Po aty*, fl. 16. Prefektura e Gjirokastrës dërguar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 21 nëntor 1927.

Mirëpo, këto sugjerime u kundërshtuan nga pleqësitë e katundeve grekofone¹².

Ministria e Arsimit këmbëngulte në zbatimin me korrektesë të legjislacionit për shkollat e minoritetit, i cili parashikote që ato të vepronin në bazë të programeve të miratuara prej saj, t'i nënshtroheshin kontrollit, mësuesit të ishin nënshtetas shqiptarë, financimi i shkollave private të bëhej vetëm me të ardhurat e fshatrave minoritare dhe jo nga burime të jashtme apo të fshehta dhe të jepej si orë mesimi edhe gjuha zyrtare, pra gjuha shqipe. Ajo udhëzonte që gjuha shqipe të mësohej në shkollat greke në klasën II, III, IV, në klasat V dhe VI do të mësohej dhe historia e gjeografia e Shqipërisë, ndërsa gjuha e mësimit në të gjitha lëndët e tjera dhe në të gjitha klasat do të ishte gjuha greke¹³. Strategjia që po ndiqte Ministria e Arsimit synonte që të respektonte angazhimet e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve për respektimin e të drejtave të minoritetit grek, por pa i deformuar ato në dëm të interesave të shtetit shqiptar. Ajo kishte dhënë leje për çeljen e shkollave private greke në minoritet, ndërsa për mësimin e gjuhës shqipe kishte emëruar mësues të posaçëm në disa fshatra kryesore. Ajo po vepronte në një mënyrë graduale për të mos shkaktuar pakënaqësi tek popullsia grekofone, prandaj në nëntor 1927 nuk e miratoi propozimin për largimin e menjëhershëm nga puna të mësuesve që nuk dinin gjuhën shqipe, pasi kjo masë do të çonte në mbylljen e shkollave¹⁴.

Megjithë këto mosmarrëveshje midis popullsisë minoritare dhe organeve shtetërore për problemet arsimore, në aspektet e tjera, siç konstatonte edhe prefektura e Gjirokastrës, situata ishte përmirësuar. Popullsia grekofone në vitin 1927 kishte ndryshuar mjaft nga qëndrimet e vitit 1922. Shumica e saj kishte avancuar në mësimin e gjuhës shqipe dhe kishte dhënë prova të respektimit të ligjeve dhe rregullave si shtetas shqiptar, ku më i spikatur ishte rasti i zgjedhjes së një deputeti grek në vendin që kishte lënë vakant deputeti Vasil Bamihë. Popullsia grekofone kishte preferuar të votonte, sipas porosive të prefektit të Gjirokastrës, në

¹² *Po aty*, F. MA, V. 1927, D. 186, fl. 1. Lutje e pleqësive të Pogonit drejtuar A. Zogut, 20 nëntor 1927.

¹³ *Po aty*, F. MPB, V. 1927, D. 159, fl. 15. Ministria e Arsimit drejtuar drejtorisë së shkollave, Gjirokastrë, Libohovë, Delvinë, 7 nëntor 1927.

¹⁴ *Po aty*, fl. 24. Ministria e Arsimit drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 21 nëntor 1927.

favor të kandidatit qeveritar Harallamb Papadhopulli dhe jo sipas rekomandimeve që i kishin bërë konsujt e Greqisë, që të votonte për nacionalistin dhe propagandistin e njohur grek, Mihal Lezo¹⁵.

Respektimi i *status quo*-së së shkollave greke në zonën e minoritetit grekofon lidhej edhe me premtimet verbale që kishte marrë qeveria shqiptare nga ajo greke se do të çelte shkolla shqipe në Çamëri¹⁶. Në vitin 1927, shkollat private greke me 6 klasë kishin këtë frekuentim¹⁷:

Qarku i Gjirokastrës	114 djem	73 vajza
Qarku i Libohovës	282 djem	166 vajza
Qarku i Delvinës	915 djem	57 vajza
Gjithsej	1311 djem	296 vajza

Edhe në fillim të vitit 1928, autoritetet shtetërore vijuan të toleronin mosdhënien e gjuhës shqipe në shkollat private të minoritetit. Atyre mësuesve që nuk ishin të aftë të jepnin gjuhën shqipe u ishte dhënë një afat tjetër, deri në fund të vitit shkollor, që ta mësonin këtë gjuhë. Deri në këtë kohë nuk ishte marrë asnjë masë penguese për ata mësues që nuk dinin gjuhën shqipe dhe nuk ishte mbyllur asnjë shkollë private¹⁸. Por, nga vera e vitit 1928, autoritetet shtetërore u bënë më këmbëngulëse dhe më rezultative në hetimin e shkeljeve të ligjit nga mësuesit e shkollave greke, si për shembull lidhjet që ata mbanin me sillojet vorio-epirote, rrogat që merrnin nga Greqia dhe për propagandën antishqiptare që zhvillonin. Mësuesit që kryenin këto veprime nuk u jepej leja për të dhënë mësim në shkollat private greke ose pushoheshin nga puna¹⁹.

Në vitin 1928, në prefekturën e Gjirokastrës funksiononin 62 shkolla private greke, 24 prej tyre ishin të njohura zyrtarisht. Në këto shkolla kishte 24 mësues zyrtarë të emëruar prej Ministrisë së Arsimit për të

¹⁵ *Po aty*, F. MPB, V. 1927, D. 159, fl. 45. Prefektura e Gjirokastrës drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 21 dhjetor 1927.

¹⁶ *Po aty*, fl. 30. Ministria e Arsimit drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 28 dhjetor 1927.

¹⁷ *Po aty*, F. MA, V. 1927, D. 61, fl. 9. Statistikë e nxënësve të shkollave private greke.

¹⁸ *Po aty*, F. MA, V. 1927, D. 185, fl. 46. Ministria e Arsimit drejtuar Kryesisë së Republikës, 29 janar 1928; *po aty*, F. MA, V. 1927, D. 159, fl. 38-40. Prefektura e Gjirokastrës drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 9 shkurt 1928.

¹⁹ *Po aty*, F. MPB, V. 1928, D. 216, fl. 1-20.

dhënë mësimin e gjuhës shqipe në lëndët e caktuara. Përveç këtyre, kishte dhe 38 shkolla private, në të cilat nuk kishte mësues të emëruar për gjuhën shqipe dhe, kështu, në këto shkolla nuk jepej asnjë orë mësimi në këtë gjuhë. Por, të dy kategoritë e shkollave po sabotonin dhënien e gjuhës shqipe. Gjithsesi, gjendja e arsimit në zonën e minoritetit kishte ardhur duke u përmirësuar. Në qytetin e Delvinës funksiononte rregullisht shkolla shtetërore mashkullore mikse me 147 nxënës, në gjashtë klasa (71 nxënës ishin grekofonë, 76 ishin shqiptarë). Në këtë qytet ekzistonte edhe shkolla femërore me 114 nxënëse. Një shkollë të mirë kishte Dhrovjani. Ajo kishte gjashtë klasa me 161 nxënës (101 djem dhe 60 vajza). Shkolla funksiononte sipas rregullave shtetërore. Shkolla shtetërore e Leshnicës gjendej në një godinë të vjetër, por ndërtesa e re po bëhej gati për vitin e ardhshëm. Aktiviteti i saj ishte në përputhje me ligjin. Ndërtesa të mira kishin edhe shkollat shtetërore minoritare të fshatrave Dhivër, Jermë, Leshnicë e Poshtme, Finiq, Çukë, Lefterohor. Në këto shkolla gjuha shqipe jepej në një nivel relativisht të mirë. Ndërsa, shkollat shtetërore të Alikos, Ymer Efendiut, Verionit, kishin ndërtesa të mira por gjuha shqipe nuk jepej fare ose jepej në një nivel shumë të ulët. Në qarkun e Konispolit funksiononin edhe disa shkolla private greke si në Hajdar Aga, Hoxh-Kullurice, Kalivja-Pasha, Theollog, Grazhdan, Zvërnec, në të cilat, me përjashtim të Theollogut, gjuha shqipe nuk jepej fare. Ndërsa një pjesë e madhe e tyre kishin ndërtesa të papërshtatshme²⁰.

Shkollat shtetërore, ndonëse financoheshin kryesisht nga qeveria shqiptare, kishin edhe mësues që paguheshin nga qeveria greke, të cilët ishin toleruar nga pala shqiptare për të mos acaruar marrëdhëniet me shtetin grek por edhe sepse pagat e tyre jepeshin fshehtas nga emisarë të ndryshëm të ngarkuar me këtë detyrë. Kështu, në qarkun e Gjirokastrës në vitin 1929 funksiononin 23 shkolla minoritare greke që kishin statusin e shkollave shtetërore ose qeveritare. Secila prej tyre kishte nga një mësues të paguar nga shteti (përveç asaj të Dhrovjanit që kishte katër) dhe nga një ose dy mësues privatë. Mësuesit shtetërorë, në shumicën e tyre, ishin shqiptarë, ndërsa pakica ishin grekofonë, por që e dinin gjuhën shqipe. Ndërsa shumica e mësuesve privatë të këtyre shkollave shtetërore

²⁰ AQSH, F. MA, V. 1928, D. 5, fl. 13. Raport i Inspektorisë së Arsimit në Tiranë, mbi shkollat greke, 15 korrik 1928.

nuk e njihnin gjuhën shqipe. Në këto shkolla mësimi i gjuhës greke bëhej si mësim gjuhe dhe feje, ndërsa lëndët e tjera mësoheshin në gjuhën shqipe.²¹Në këtë vit kishte edhe 28 shkolla private të cilat vijonin të mos jepnin si lëndë mësimi gjuhën shqipe²².

Me qëllimin që të ndryshohej situata e krijuar, prefektura e Gjirokastrës sugjeroi marrjen e disa masave për të cilat mendonte se nuk binin ndesh me Deklaratën shqiptare për minoritetet si: në çdo shkollë qeveritare mësuesit të ishin shqiptarë dhe, në qoftë se nuk do të ishte e mundur që të ishin të gjithë, të paktën ata mësues grekofonë që do të emëroheshin, të dinin mirë gjuhën shqipe dhe të ishin të pëlqyeshëm prej autoriteteve të vendit; të gjithë mësuesit e shkollave shtetërore të paguheshin nga qeveria shqiptare dhe të mos lejohej asnjë mësues privat në to; drejtori ose kryemësuesi të ishin doemos shqiptarë; në shkollat me pesë klasa të emërohej një mësues shqiptar për gjuhën shqipe dhe punën e dorës; të gjitha mësimet të jepeshin në gjuhën shqipe dhe gjuha greke të mësohej vetëm si gjuhë dhe besim fetar; për mësimin e gjuhës greke të përdoreshin libra me lëndë të përkthyer nga tekstet shqiptare dhe të mos lejohej përdorimi i teksteve të shtypura në Greqi ose në Stamboll²³.

Për shkollat private greke propozoheshin këto masa: të zbatonin të njëjtin program mësimor si shkollat qeveritare; mësuesit të ishin grekofonë, nënshtetas shqiptarë që të dinin medoemos edhe gjuhën shqipe; gjuha shqipe të ishte e detyrueshme në të gjitha lëndët shkollore përveç orës së fesë dhe të gjuhës greke; tekstet shkollore të ishin të njëjta me ato të shkollave qeveritare; shkollat private të kishin ndërtesa të posaçme, të përshtatshme dhe të plotësuara me të gjitha orënditë shkollore; mësuesit e shkollave private të emëroheshin nga qeveria; pagat e tyre të depozitoheshin në arkën e komunës nga pleqësitë e fshatrave, në të cilën merrnin rrogat edhe nëpunësit e tjerë komunalë. Masa e fundit propozohej pasi kontratat që bënin pleqësitë me mësuesit ishin formale, ndërsa pagesa e vërtetë e rrogave bëhej nga organizatat vorio-epirote²⁴.

²¹ *Po aty*, F. MPB, V. 1929, D. 206, fl. 3-5. Prefektura e Gjirokastrës drejtuar Ministrisë së Arsimit, 25 prill 1929.

²² *Po aty*.

²³ *Po aty*.

²⁴ *Po aty*.

Duke u bazuar në këtë raport, Ministria e Brendshme i sugjeroi Ministrisë së Arsimit marrjen e masave të shpejta për përmirësimin e gjendjes në shkollat grekofone, në bazë të dispozitave të Statutit të Mbretërisë, i cili përcaktonte si nëpunës të shtetit vetëm ata që ishin nënshtruar shqiptarë dhe që dinin shkrim dhe lexim në gjuhën shqipe. Gjithashtu, ajo theksonte se në të ardhmen, për të penguar propagandën që po zhvillonte qeveria greke nëpërmjet organizatave vorio-epirote, do të shpenzoheshin fonde të konsiderueshme nga shteti shqiptar, por çështja duhej studiuar²⁵. Mirëpo, për realizimin e këtij objekti, siç vinte në dukje edhe Ministria e Arsimit, kërkoheshin shpenzime të shumta për botimin e librave në gjuhën greke në Shqipëri, për pajisjen e shkollave me vegla e orendi shkollore dhe një personel i mjaftueshëm dhe i aftë që të dinte gjuhën shqipe dhe atë greke²⁶.

Dy inspektorë të Ministrisë së Arsimit, Jani Minga dhe Ibrahim Sejfullahu, pasi kryen një inspektim të shkollave greke, përgatitën në maj 1929, një raport në të cilin evidentoheshin më konkretisht problemet në shkollat greke²⁷. Sipas këtij raporti, në qarkun e Delvinës, vetëm në shkollat e Kakodhiqit, Finiqit dhe Çukës mësimi po zhvillohej sipas rregullave, pasi mësuesit e këtyre katundeve e dinin gjuhën shqipe, pothuajse si shqiptarët, dhe i kishin kushtuar kujdes mësimin të saj. Në tri shkollat e tjera (Kardhikaq, Lefterohor e Vrion) nuk zbatoheshin asnjë rregull sepse mësuesit nuk e dinin gjuhën shqipe. Mësimi po zhvillohej sipas programit të Ministrisë së Arsimit vetëm në ato shkolla ku kishte mësues shqiptarë e grekofonë që zotëronin të dyja gjuhët. Por, duke u gjendur përballë një organizate të fortë nacionaliste greke që e zhvillonte aktivitetin brenda dhe jashtë kufirit shtetëror, programi zyrtar që ishte në përputhje me Deklaratën e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, nuk zbatoheshin dhe sabotoheshin. Masat që kishte marrë Ministria e Arsimit deri në atë kohë, konsideroheshin të pamjaftueshme. Inspektorët rekomandonin marrjen e disa masave efektive shtesë për mësimin në gjuhën shqipe dhe për kufizimin e greqishtes vetëm në mësimin e gjuhës dhe të fesë. Ata

²⁵ *Po aty*, fl. 7. Ministria e Punëve të Brendshme drejtuar Ministrisë së Arsimit, 1 maj 1929.

²⁶ *Po aty*, fl. 9. Ministria e Arsimit drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 13 maj 1929.

²⁷ *Po aty*, fl. 10-12. Raport i inspektorëve të MA, Jani Minga e Ibrahim Sejfullahu, 29 maj 1929.

konstatonin se, për të bërë këtë ndryshim, ekzistonte një frymë pozitive tek popullsia grekofone, e cila e kishte kuptuar tashmë, më mirë se kurrë më parë, që interesat e jetës së saj ishin në përputhje me masat që sugjeroheshin të merreshin²⁸. Sipas tyre duheshin marrë këto masa konkrete: shkollat private që kishin ndërtesa të shkatërruara dhe nuk u përgjigjeshin kërkesave pedagogjike e shëndetësore të mbylleshin; dy ose tri shkolla që nuk kishin largësi midis tyre më tepër se 20 minuta të bashkoheshin në një shkollë qendrore, me një kryemësues qeveritar shqiptar dhe një mësues privat që të zotëronte të dy gjuhët; shkollat private, me largësi deri në 20 minuta me shkollat shtetërore të bashkoheshin me to. Kështu që, jo vetëm do të pakësohej numri i shkollave private greke, "por arsimit kombëtar do të çlirohej nga një frymë e huaj dhe antishqiptare"²⁹. Raporti rekomandonte që të shtoheshin kompetencat e inspektorëve të arsimit për shpërnguljen ose pushimin nga puna të mësuesve që nuk zbatonin programin zyrtar. Për të mënjanuar dëmin që po i sillnin karakterit kombëtar shqiptar të arsimit në minoritet, këta mësues antishqiptarë e fanatikë, propozohej çelja gjatë pushimeve verore e një kursi të veçantë për mësuesit grekofonë të shkollave private e qeveritare që paguheshin prej komuniteteve, që ata të mësonin gjuhën shqipe, të cilën pastaj duhej ta jepnin provim. Kështu, mësuesit e paaftë dhe kundërshtarë të mësimin të gjuhës shqipe do të përjashtoheshin nga mësimdhënia në këto shkolla. Në këtë mënyrë, do të frenohej tendenca e pleqësive për të emëruar mësues që pengonin ose kundërshtonin dhënien e gjuhës shqipe³⁰.

Duke konstatuar se midis popullsisë grekofone ekzistonin shumë persona me qëndrime luajale ndaj shtetit shqiptar, Ministria e Brendshme, në korrik të vitit 1929, porositi Prefekturën e Gjirokastrës të studionte dëshirat e tyre për të arsimuar fëmijët në shkollat shqiptare. Kështu, shumë djem grekofonë që studionin më parë në Greqi, shfaqën dëshirën që të kryenin arsimin elementar të mesëm në shkollat shqiptare me bursa të shtetit shqiptar. Ministria e Brendshme i mirëpriti këto kërkesa dhe sugjeroi që në vitin e ri shkollor 1929-1930 t'u siguroheshin atyre vende në shkollat shqiptare me bursa të shtetit. Ajo, mendonte se,

²⁸ *Po aty.*

²⁹ *Po aty.*

³⁰ *Po aty.*

kjo sakrificë ia vlente pasi do të ndikonte së tepërmi në fashitjen e ndjenjave antishqiptare që u inspiroheshin këtyre djemve nga shkollat greke³¹. Edhe prefektura e Gjirokastrës këmbëngulte që të rritej numri i bursave që i jepej elementit grekofon me qëllim që t'i mbylleshin shtigjet propagandës greke dhe të krijohej midis grekofonëve një element pro shqiptar i shëndetshëm. Ajo ndjente si një shqetësim kryesor në këto çaste, mungesën e mësuesve korrektë dhe besnikë ndaj shtetit shqiptar nëpër shkollat greke, të cilën shpresonte ta plotësonte me këta bursistë që do të mbaronin studimet në Normalen e Elbasanit³².

Ministria e Arsimit i mirëpriti këto propozime dhe mori masat përkatëse. Në gusht të vitit 1929, numri i djemve grekofonë që kishin kërkuar të ndiqnin shkollat shqiptare me bursë shteti ishte 115 veta. Prefektura e cilësonte këtë numër të madh, dhe mendonte se ai do të ishte edhe më i madh, në qoftë se do t'i shtoheshin ata që kishin kërkuar bursa për në konviktin Çamëria. Ajo kërkonte shtimin e numrit të bursistëve të këtij konvikti nga 10 në 25 veta dhe 2/3 e tyre të ishin grekofonë, kurse 1/3 shqiptarë, me të vërtetë të varfër³³. Edhe nënprefektura e Delvinës propozoi ngritjen e një shkolle fillore me internat [konvikt] për fëmijët grekofonë në Delvinë. Gjithashtu, ajo kërkonte që të merreshin masa efektive për të konkurruar internatet dhe shkollat elementare greke rreth kufirit, të cilat po tërhiqnin edhe djemtë shqiptarë, duke shfrytëzuar vobektësinë e tyre dhe po i indoktrinonin me propagandën nacionaliste greke³⁴. Në këtë kuadër, edhe Ministria e Brendshme urdhëroi ndalimin e përkohshëm të ndjekjes së shkollave greke nga nxënësit shqiptarë deri sa të merrte një përgjigje përfundimtare nga Ministria e Jashtme³⁵.

Në verë të vitit 1929, Ministria e Arsimit urdhëroi që mësuesit privatë të katundeve grekofone t'u nënshtroheshin provimeve për gjuhën shqipe në Gjirokastër. Ata që nuk e fitonin këtë provim ose që nuk pranonin t'i nënshtroheshin atij do të largoheshin nga puna dhe, në vend

³¹ *Po aty*, F. MPB, V. 1929, D. 205, fl. 4. Ministria e Punëve të Brendshme drejtuar Ministrisë së Arsimit, 26 korrik 1929.

³² *Po aty*, fl. 5. Prefektura e Gjirokastrës drejtuar Ministrisë së Arsimit, 29 korrik 1929.

³³ *Po aty*, fl. 13. Prefektura e Gjirokastrës drejtuar Ministrisë së Arsimit, 23 gusht 1929.

³⁴ *AQSh*, F. MPB, V. 1929, D. 206, fl. 29-30. Nënprefektura e Delvinës drejtuar prefekturës së Gjirokastrës, 19 shtator 1929.

³⁵ *Po aty*, F. MPB, V. 1929, D. 508, fl. 1. Ministria e Punëve të Brendshme drejtuar Kryeministrisë, 7 tetor 1929.

të tyre, do të propozoheshin të tjerë që do të kishin cilësitë e duhura. Kështu që, në vitin e ri shkollor, nuk do të përsëritej asnjë kontratë me pleqësitë e katundeve grekofone me mësuesit privatë para se ata t'i nënshtroheshin provimit të gjuhës shqipe.³⁶ Prefektura e Gjirokastrës i dërgoi Ministrisë së Arsimit edhe një listë me disa mësues grekofonë antishqiptarë dhe të rrezikshëm, duke kërkuar pushimin e tyre nga puna³⁷. Për të vendosur kontrollin e shtetit mbi aktivitetin e shkollave private grekofone, qeveria mori masa që kryepleqësitë e katundeve të depozitonin rrogën e mësuesve privatë në arkën e Komisionit Shkollor të prefekturës. I vetmi fshat që rezistonte kundër zbatimit të këtij rregulli ishte Dervicani, i cili konsiderohej më i pabinduri në atë rajon³⁸.

Qeveria greke reagoi menjëherë kundër këtyre masave. Ministri i Jashtëm i Greqisë deklaroi se në Shqipëri ishin mbyllur shkollat e minoritetit dhe ishin ndaluar mësuesit të jepnin mësim në to. Por, Ministria e Arsimit e përgënjeshtroi këtë akuzë, duke u përgjigjur se shkollat greke funksiononin në rregull dhe nuk ishte mbyllur asnjë prej tyre. Madje, edhe mësuesit që nuk dinin gjuhën shqipe ishin lejuar të vijonin punën deri në një urdhër të ri³⁹. Gjithashtu, Ministria e Arsimit po planifikonte të botonte dhe 6.000 libra leximi për shkollat greke⁴⁰. Në vitin 1929, në Shqipëri funksiononin 22 shkolla greke që financoheshin nga shteti shqiptar dhe 32 shkolla private që mbaheshin formalisht nga komuniteti grekofon, por realisht nga qeveria greke dhe organizatat vorio-epirote jashtë Shqipërisë. Në këto shkolla shërbenin 90 mësues (62 grekofonë dhe 28 shqiptarë). Numri i përgjithshëm i nxënësve grekofonë në këto shkolla ishte 3.003. Për mbajtjen e shkollave shtetërore, shteti shqiptar shpenzoi këtë vit 61.000 fr. ari⁴¹.

³⁶ *Po aty*, F. MPB, V. 1929, D. 206, fl. 21. Qarkore e Ministrisë së Arsimit.

³⁷ *Po aty*, fl. 23-24. Prefektura e Gjirokastrës drejtuar Ministrisë së Arsimit, 26 gusht 1929.

³⁸ *Po aty*, F. MPB, V. 1929, D. 810, fl. 2. Drejtoria e Shkollës Plotore Gjirokastrë, drejtuar Ministrisë së Arsimit, 17 tetor 1929.

³⁹ *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AMPJ*), viti (më tej: V.) 1929, dosja (më tej: D.) 794, fl.2. Ministria e Arsimit drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme, 19 nëntor 1929.

⁴⁰ *AQSh*, F. MA, V. 1929, D. 398, fl.5-6. Ministria e Arsimit drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme, 2 nëntor 1929.

⁴¹ *AMPJ*, V. 1929, D. 797, fl. 7. Pasqyrë përmbledhëse e shkollave të minoriteteve etnike në Shqipëri.

Shqetësime për mënyrën e shpërblimit të mësuesve të shkollave greke shfaqti dhe Kryesia e Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare (KOASH). Ajo i kërkoi Ministrisë së Drejtësisë⁴² që të hiqej dorë nga praktika e kohës së Perandorisë Osmane, kur shkollat greke financoheshin me të ardhurat kishtare, pasi gjuha greke konsiderohej si gjuhë e kishës. Tani, për mësimin e lëndës së fesë nuk ekzistonte më nevoja e këtyre shkollave, pasi këtë e bënte Seminari i Përgjithshëm Kombëtar Ortodoks që ishte në organizim e sipër. Gjithashtu, shkollat e fshatrave grekofone po financoheshin edhe nga qeveria shqiptare. Prandaj, KOASH kërkonte që të ardhurat kishtare dhe të manastireve të mos përdroreshin për mbajtjen e shkollave, por për organizatat e kishës ortodokse. Kryesia e KOASH informonte se konsullatat greke në Shqipëri po i nxisnin grekofonët të bënin çdo përpjekje që të merrnin nga arka e manastireve rrogën e mësuesve privatë. Kështu, forcohej propaganda greke dhe, në anën tjetër, dobësohej KOASH, duke i pakësuar mjetet ekonomike. Fenomeni i marrjes së të ardhurave të manastireve ishte i ri. Deri në këtë kohë grekofonët nuk kishin mundur të përdornin të ardhurat e manastireve për shkollat greke. Ata ishin mjaftuar vetëm me përpjekjet për të shtënë në dorë administrimin e pasurisë së manastireve, duke mos i administruar ato sipas rregullores së kishës dhe në dobi të arkës së përgjithshme të saj, megjithëse nuk ia kishin arritur qëllimit të tyre⁴³. Kërkesën për të përdorur të ardhurat e manastireve për shkollat greke e kishin bërë të parët fshatarët e Dhrovjanit. Ata kishin kërkuar edhe mbështetjen e deputetit të Gjirokastrës, Thoma Papapanos. Më tej, kishin marrë të ardhurat e manastirit dhe i kishin përdorur për rrogat e mësuesve privatë. Kryetari i KOASH, Visarioni [Xhuvani], ishte i shqetësuar se këtë shembull mund ta ndiqnin edhe katundet e tjera grekofone dhe, kështu, do t'i jepej një goditje e rëndë KOASH, pasi shuma më e madhe e të ardhurave kishtare ishte nga të ardhurat e manastireve të Gjirokastrës⁴⁴. Ministria e Drejtësisë i kërkoi Ministrisë së Brendshme që të informonte prefekturat se të ardhurat e kishave e të manastireve, sipas nenit 40 të Statutit të Komunitetit Ortodoks, ishin

⁴² *AQSh*, F. MPB, V. 1930, D. 187, fl. 120. Kryesia e KOASH drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, 22 korrik 1930.

⁴³ *Po aty*.

⁴⁴ *Po aty*.

pasuri e Kishës Ortodokse, prandaj ato nuk mund të përdoreshin kurrsesi për qëllim tjetër⁴⁵.

Veprimtaria e nacionalistëve grekë dhe e organizatave vorio-epirote në sferën e arsimit

Nacionalistët grekë dhe organizatat vorio-epirote kishin një ndikim të madh në zonën ku banonte minoriteti grek. Në dokumentacionin shqiptar evidentohet fakti se në krahinën e Poliçanit ishte formuar një komision i përbërë nga Dr. Kiçati, Dr. Ilia Zëri dhe tregtari Panajot Leka nga Dropulli, të cilët kishin për detyrë të mbikëqyrnin dhënien e gjuhës greke në shkolla dhe të ndihmonin propagandistët grekë. Këtij komisioni, qeveria greke i jepte shumë të holla si dhe librat që nevojiteshin për nxënësit e shkollave. Një grup nacionalistësh grekë si, Vasil Shahini, Spiro Diamanti e Kiço Papai nga Dropulli po përpiqeshin të alarmonin popullsinë grekofone duke e trembur se xhandarmëria shqiptare po ndalonte mësuesit që të jepnin gjuhën greke. Ata kishin nënshkruar vetë disa peticione të rreme në emër të popullsisë minoritare dhe ia kishin dërguar qeverisë shqiptare. Ndërsa pleqësitë e fshatrave grekofone nuk i konfirmonin këto ankesa. Ata deklarorin se, xhandarmëria shqiptare nuk ishte përzier fare në çështjen e shkollave dhe nënshkrimet ishin të falsifikuara, ata ishin vënë prej V. Shahinit dhe shokëve të tij.⁴⁶ Ky veprim ishte ndërmarrë si kundërpërgjigje për pushimin nga puna të disa mësuesve të shkollave private minoritare ngaqë ata nuk dinin gjuhën shqipe ose kishin refuzuar dhënien e saj si orë mësimi gjuhe në këto shkolla.

Por, kishte edhe raste kur disa fshatra grekofone kërkuar vetë emërimin e mësuesve të gjuhës shqipe. Një kërkesë të tillë bënë katundet Grazhdan e Vagalat të nënprefekturës së Çamërisë, të cilët kishin shkolla private në gjuhën greke⁴⁷. Kjo ishte dëshmi e luajalitetit dhe dëshirës së këtyre banorëve për t'u integruar në shtetin shqiptar, duke ruajtur

⁴⁵ *Po aty*, F. MPB, V. 1930, D. 187, fl. 132. Ministria e Drejtësisë drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 31 korrik 1930.

⁴⁶ *Po aty*, F. MPB, V. 1927, D. 47, fl.1-2. Komanda e xhandarmërisë së qarkut Gjirokastër drejtuar Komandës së Përgjithshme të Xhandarmërisë, 2 janar 1927.

⁴⁷ *Po aty*, F. MPB, V. 1927, D. 159, fl. 8. Nënprefektura e Çamërisë drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 3 qershor 1927.

njëkohësisht gjuhën dhe identitetin e tyre. Nënprefektura e Çamërisë kërkonte që të emëroheshin tre mësues të gjuhës shqipe me ndjenja patriotike në tre katundet kryesore grekofone, Grazhdan, Vagalat e Theollogo. Emërimi i këtyre mësuesve vlerësohej prej saj edhe si një mënyrë për të goditur propagandën greke, e cila ishte intensifikuar dhe synonte që t'i largonte këto fshatra nga rruga e integritit dhe bashkëjetesës normale e paqësore në shtetin shqiptar.

Organizatore dhe nxitëse kryesore e propagandës për sabotimin e gjuhës shqipe në shkollat greke ishte shoqëria vorio-epirote, e cila, ishte shpallur shoqëri arsimore. Sipas burimeve shqiptare, ajo kishte çelur shkolla e internate në afërsi të kufirit shqiptar si në Korfuz, Janinë, Filat, Konicë etj., të cilat 80% të nxënësve i merrnin nga viset e Shqipërisë. Gjithashtu, kishte çelur shkolla greke edhe në katundet e vogla grekofone në Shqipëri, duke paguar rrogat e mësuesve, duke siguruar librat etj.⁴⁸ Nga ana tjetër, krerët e organizatave vorio-epirote, Spiro Milo, Kostaq Skënderi, Janaq Spiro e Telemak Skuti gjatë vitit 1927 bënë sulme të shumta publike kundër qeverisë shqiptare, të cilën e akuzonin se kishte mbyllur të gjitha shkollat greke dhe kishte pushuar nga puna gjithë mësuesit grekofonë⁴⁹. Në këtë kuadër, sillogjet vorio-epirote të Athinës bënë një mbledhje në Pire, ku protestuan kundër qëndrimit të shtetit shqiptar ndaj shkollave greke. Zyra e shtypit e Ministrisë së Jashtme të Shqipërisë i hodhi poshtë këto akuza si krejt të pabaza dhe deklaroi se, Shqipëria ishte i vetmi shtet në Ballkan që i respektonte me përpikëri detyrimet e saj që rridhnin nga traktatet e minoriteteve. Ajo pohonte se, në Shqipëri kishte 70 shkolla greke, dhe për nevojat e tyre, shteti shqiptar shpenzonte mesatarisht 70.000 fr.ari në vit⁵⁰.

Krerët kryesorë të propagandës greke ishin Dr. Kiçati e Jani Foto në Pogon, Kristo Babako, Dhimosten Haxhioglli [një ish mësues privat që në këtë kohë ishte emëruar mësues edhe nga Ministria e Arsimit] dhe Andon Papa Kristo në Poliçan, të cilët vijonin të merrnin rrogë nga Greqia; Dr. Ilia Zëri nga Sopiku, Harallamb Pano nga Hllomoja dhe

⁴⁸ *Po aty*.

⁴⁹ *Po aty*, F. MPB, V. 1927, D. 47, fl. 10-11. Legata e Shqipërisë Athinë, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme, 8 dhjetor 1927.

⁵⁰ *AMPJ*, V. 1927, D. 208, fl.13. Qarkore e Ministrisë së Punëve të Brendshme drejtuar prefekturave.

Panajot Vasiljadhi nga Çatista, veprimtarinë antiligjore të të cilit e kishte pohuar edhe pleqësia e fshatit, e cila e kishte pushuar nga puna si mësues zyrtar. Në Dropullin e Sipërm krerët e propagandës nacionaliste greke ishin mësuesi i fshatit Jergucat, Jorgji Taka, mësuesi zyrtar i Bularatit, Stilian Papadhpulli, ish mësuesi i katundit Klishar, Vasil Dajlani, Jorgji Kalivopulli (i cili mernte nga Greqia një rrogë sa ajo e një shefi seksioni në Ministrinë e Arsimit), Jorgji Buxhi nga Sotira, avokati Vasil Shahini nga Dropulli, Spiro Diamanti nga Dervicani e Kiço Papaj nga Goranxia. Që të gjithë këta nxisnin pleqësitë e katundeve grekofone të ankoheshin dhe të kërkonin që në shkollat shtetërore të minoritetit, të kundërshtonin dhënien e lëndëve të ndryshme në gjuhën shqipe dhe të kërkonin që të gjitha ato të jepeshin në gjuhën greke.⁵¹

Një fakt interesant është se, kjo veprimtari e ethshme shkaktoi reagime edhe nga ndonjë individ i veçantë grekofon, i cili u trembej pasojave që do të kishte ajo për marrëdhëniet e minoritetit me shtetin shqiptar. Kështu, Kosta Jani Konomi nga Sopiku i shkruante Presidentit A. Zogu se “nuk duhet t’u jepni komuniteteve grekofone të drejtën të përdorin gjuhën amtare gjerësisht në shkollat e tyre dhe as të lejoni mësuesit përkatës që të paguhen prej një fqinji të huaj sepse kjo e ngarkon popullin tuaj me obligacione kundrejt atij fqinji, i cili përpiqet me çdo mënyrë të rrëzojë e të zhdukë themelet e shtetit shqiptar”⁵².

Organizatorët e kësaj fushate, në vjeshtën e vitit 1927, nxitën edhe bojkotin e shkollave nga nxënësit minoritarë. Gjysma e nxënësve të Sopikut në këtë kohë nuk shkonin në shkollë. Iniciator kryesor i këtij bojkotimi ishte Dr. Ilija Zëri, i cili kishte vajtur në Greqi me qëllim që të fitonte përkrahjen e qeverisë greke, për t’i adresuar protesta Lidhjes së Kombeve, lidhur me pezullimin nga puna të disa mësuesve privatë, sepse ata nuk dinin gjuhën zyrtare shqipe⁵³. Në të vërtetë, po vijonte një duel i heshtur midis qeverisë shqiptare që donte ta fuste edhe mësimin e gjuhës shqipe në shkollat private greke dhe mësuesve të këtyre shkollave të cilët,

⁵¹ *AQSH*, F. MPB, V. 1927, D. 47, fl. 2. Komanda e Xhandarmërisë Libohovë, drejtuar Komandës së Përgjithshme të Xhandarmërisë, Tiranë, 25 dhjetor 1927.

⁵² *Po aty*, fl. 3. Letër e Kosta Jani Konomit nga Sopiku, drejtuar A. Zogut, 6 tetor 1927.

⁵³ *Po aty*, F. MPB, V. 1927, D. 159, fl. 22. Komanda e Postës Poliçan, drejtuar Rrethkomandës Libohovë, 6 nëntor 1927.

të shtyrë nga disa deputetë dhe konsuj grekë, synonin ta sabotonin⁵⁴. Madje, avokati grekë nga Gjirokastra, Vasil Shahini kishte arritur gjer atje sa të shkruante ankesa edhe në emër të pleqësisë së fshatrave shqiptare Frashtan e Lugar, se gjoja ata kërkonin hapjen e shkollave grekë. Ai e pohoi vetë përpara autoriteteve të prefekturës së Gjirokastrës se po vepronte sipas udhëzimeve të deputetit të Parlamentit të Shqipërisë, Bozhori⁵⁵.

Financimi i mësuesve grekë me paga të larta, të fshehta ishte një shtysë për rezultatet e kësaj veprimtarie. Mësuesit privatë grekë, përgjithësisht, kishin lidhur kontrata me komunitetet e katundeve sipas të cilave formalisht rroga më e lartë ishte 3-4 napolona në muaj, pra ishte një pagë e ulët për kushtet e kohës. Kjo dëshmonte se, ata merrnin pagë shtesë nga Greqia, si agjentë dhe propagandistë të saj, pasi nuk mund të justifikoheshin angazhimi i tyre me një rrogë kaq të vogël, me të cilën nuk mund të përballonin as shpenzimet për veten e tyre. Por, as këto 3-4 napolona të përcaktuara me kontratë nuk mund të paguheshin prej katundeve sepse asnjë katund grekë nuk kishte aq të ardhura komunale sa të paguante mësuesit në fjalë. Kështu, për shembull, Poliçani, për tre mësues privatë që kishin diplomën e shkollës normale dhe gjimnazit, paguante, sipas kontratave, 125 napolona në vit. Mirëpo, ky katund kishte gjithsej 85 napolona të ardhura, nga kullota, nga një mulli, një kafene etj. Prej kësaj shume duhej të hiqeshin edhe shpenzimet që bënte fshati për priftin dhe kishën. Kështu që, prej këtyre të hollave nuk mbetej asgjë, përveç një shume fare të vogël. Në këtë gjendje ishin të gjithë katundet grekë që kishin shkolla.

Meqë edhe mësuesit e emëruar zyrtarisht po sabotonin dhënien e orës së mësimi të gjuhës shqipe, Inspektoria e Arsimit pranë Ministrisë së Arsimit kërkoi në maj të vitit 1928, transferimin e tyre në Shqipërinë e Veriut ose në Shqipërinë e Mesme, sepse ata po punonin për përhapjen e grekomanizmës në këtë rajon⁵⁶. Por, kjo masë nuk u vu në zbatim. Autoritetet e larta shtetërore ishin të kujdesshëm dhe vazhdimisht hodhën

⁵⁴ *Po aty*, fl. 28. Prefektura e Gjirokastrës drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 26 nëntor 1927.

⁵⁵ *Po aty*, fl. 45. Prefektura e Gjirokastrës drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 21 dhjetor 1927.

⁵⁶ *Po aty*, F. MA, V. 1928, D. 5, fl. 1-5. Zyra e Inspektorisë së Arsimit drejtuar Ministrisë së Arsimit, 27 maj 1928.

poshtë ndonjë rekomandim të tepruar e me frymë nacionaliste të nëpunësve të veçantë.

Aktivitetin arsimor në zonat e minoritetit grekofon brenda Shqipërisë e drejtonte dhe e kontrollonte me efektivitet Mitropoliti i Janinës, Spiridhoni. Autoritetet shqiptare evidentonin faktin se me të hollat e qeverisë greke, të llasave [donacioneve të lëna trashëgim] të “epirotëve” [shqiptarëve ortodoksë nga Shqipëria e Jugut] dhe financimeve nga shoqëri të ndryshme epirote që ndodheshin në Amerikë, Egjipt etj., ai paguante mësuesit grekë në shkollat greke brenda territorit shqiptar.⁵⁷ Ai bashkëpunonte ngushtësisht me konsullatat greke të Gjirokastrës e të Sarandës. Në vitin 1928, fushata për arsimimin vetëm në gjuhën greke të minoritetit kishte marrë forcë të re dhe karakter më nacionalist. Deri në këtë kohë, ishin financuar mësuesit grekofonë, nënshtetas shqiptarë, ndërsa tani po dërgoheshin nga Janina, për çdo shkollë greke edhe mësuese që kishin mbaruar Normalen e Janinës të cilat, ose nuk dinin fare shqip ose ishin porositur që të mos jepnin gjuhën shqipe në shkollat greke. Kështu po ndodhte në Sopik, Dhrovjan, Jorgucat, Poliçan, Çatistë, Dhivër (Delvinë)⁵⁸.

Inspektoria e Arsimit kërkonte marrjen e masave kundër kësaj veprimtarie në bazë të një programi sistematik, të cilat duhej të ishin proporcionalisht të balancuara dhe në të mirë të arsimit të kësaj popullsie, të shtetit dhe të interesave kombëtare. Konkretisht sugjeronte emërimin e mësuesve shqiptarë të aftë e energjikë për dhënien e gjuhës shqipe në shkollat greke dhe jo të moshuar shtatëdhjetëvjeçarë, të cilët kishin një frymë të huaj e antikombëtare; mësuesit e greqishtes të detyroheshin të mësonin të flisnin gjuhën shqipe, të emëroheshin në çdo shkollë greke mësuese shqiptare edhe nëse ato nuk e dinin gjuhën greke, pasi kjo praktikë kishte dhënë rezultat në shkollat femërore të Delvinës dhe të Himarës, ku nxënëset, të nxitura nga mësueset shqiptare, bisedonin edhe në gjuhën shqipe; të shtohet numri i bursistëve në konviktin e Sarandës, duke sistemuar djem grekofonë e shqiptarë nga zonat e ndryshme të prefekturës së Gjirokastrës e të Himarës, me qëllim që më vonë të

⁵⁷ *AQSh*, F. MPB, V. 1929, D. 206, fl.3-5. Prefektura e Gjirokastrës drejtuar Ministrisë së Arsimit, 25 prill 1929; *po aty*, F. MA, V. 1928, D. 5, fl. 7-11. Raport i Inspektorisë së Arsimit, Tiranë, dërguar Ministrisë së Arsimit, 9 qershor 1928.

⁵⁸ *Po aty*.

dërgoheshin në Normalen e Elbasanit për t'u përgatitur si mësues të kualifikuar; t'u dërgohej drejtorive të shkollave të fshatrave grekofone një qarkore rezervate për shtimin e orëve të mësimit në gjuhën shqipe dhe dhënien e greqishtes me orë të kufizuara vetëm për mësimin e gjuhës e të fesë. Mësuesit, përveç mësimit të gjuhës shqipe, të zhvillonin diskutime me nxënësit, t'u jepnin të mësonin vjersha e dialogje, gjimnastika të bëhej në gjuhën shqipe, regjistrat dhe programet të mbaheshin në shqip, me qëllim që "shqipja të bëhej vërtet zonzjë e shkollës". Në këtë mënyrë, mendohej se, shkollat greke do të ndryshonin fytyrën e tyre, e cila do të ishte më luajale e do t'i përgjigjej edhe frymës së popullsisë grekofone që kishte ndryshuar mjaft. Sipas Inspektorisë së Arsimit, kjo popullsi, duke u nisur nga interesat kryesore të jetesës, ishte e prirur të mësonte gjuhën shqipe⁵⁹. Por, këto masa, me përjashtim të shtimit të numrit të bursistëve, përgjithësisht nuk u zbatuan.

Qeveria greke vijoi të ruante ndikimin e fuqishëm në minoritet. Ajo po vepronte si shtet brenda shtetit shqiptar, duke u dhënë pension arsimtarëve të vjetër që kishin shërbyer në kohën e Perandorisë Osmane si dhe paga e pensione atyre që vijonin të jepnin mësime në shkollat minoritare. Sipas një raporti të Prokurorisë Politike, në qershor 1930, kishte 47 mësues privatë të cilët, për nga mënyra e shpërblimit të paligjshëm që merrnin, ndaheshin në tri kategori⁶⁰: 1) Një numër i vogël që merrnin një shumë të hollash nga arkat e katundeve dhe një shpërblim nga Janina; 2) Mësues që merrnin pensione të arsimit grek dhe, përveç tyre, edhe një shpërblim nga Janina; 3) Mësues organikë të arsimit grek, të cilët nuk merrnin rroga nga arkat e katundeve. Duke qenë nëpunës në organikën e Ministrisë së Arsimit të Greqisë, ata paguheshin me anë të Komisionit të Janinës nga arka e qeverisë greke. Paga e tyre ishte 3.950 dhrahmi në muaj dhe ata kishin të gjitha të drejtat financiare që kishin nëpunësit grekë jashtë shtetit⁶¹.

Ndërhyrja e hapur greke, sfida që po i bënte ligjeve ndërkombëtare për minoritetet dhe autoritetit të shtetit shqiptar në zonën e minoritetit, shkaktonte shqetësim, madje edhe nervozizëm në autoritetet qendrore

⁵⁹ *Po aty*.

⁶⁰ *Po aty*, F. MPB, V. 1930, D. 309, fl. 1-9. Prokuroria e Gjyqit të Posaçëm për Fajë Politike drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 17 qershor 1930.

⁶¹ *Po aty*.

arsimore, të cilat kërkonin marrjen e masave për ta kundërgoditur këtë ndërhyrje. Madje, në ndonjë rast, përveç masave të ligjshme e korrekte, ata sugjeruan edhe ndonjë masë me karakter nacionalist, duke kërkuar që të merrej si model një aspekt i veçantë i politikës arsimore greke. Inspektoria e Arsimit propozonte që shteti shqiptar të vepronte si “zot i vendit”. Të hiqeshin nga arsimi të gjithë ata që merrnin pensione e rroga nga qeveria greke dhe, në vend të tyre, të emëroheshin mësues shqiptarë me ndjenja kombëtare që të zotëronin të dyja gjuhët, shqipen dhe greqishten. Ky do të ishte një veprim me rëndësi të madhe kombëtare. “Shqiptarizimi themelisht i pjesës grekofone, e cila na qëndron gjemb e halë në sy, vjen dhe do vijë vetëm me anë të shkollave femërore”, theksohej në raport. Aty sugjerohej që të merrej si shembull politika arsimore e qeverisë greke, e cila kishte ngritur në Filat të Çamërisë, që ishte zemra e shqiptarëve të kësaj pjese të robëruar, një shkollë të madhe vetëm që të helenizonte këtë popullsi dhe të zhdukte gjuhën shqipe⁶². Por këto mbetën vetëm dëshira apo artikulime sporadike dhe nuk gjetën zbatim. Në përgjithësi, autoritetet shqiptare respektuan aktet ndërkombëtare për mbrojtjen e minoriteteve, duke u siguruar grekofonëve shkolla greke, zyrtare e private, dhe këtë e vlerësonin si një krenari kombëtare për vlerat humane të kombit dhe të shtetit shqiptar⁶³. Megjithëkëtë, ata vinin në dukje se toleranca që po tregohej ndaj abuzimeve që bënin propagandistët grekë po binte në kundërshtim me interesat e larta kombëtare e shtetërore dhe se do të ishte një faj i pafalshëm po të vazhdohej në këtë rrugë⁶⁴.

Gjithashtu, autoritetet shqiptare kishin kontaktuar edhe mjaft grekofonë që nuk ishin të ndikuar prej propagandës ekstremiste greke. Shumë prej tyre donin t'u mësonin fëmijëve gjuhën shqipe dhe t'i dërgonin në shkollat e mesme të Shqipërisë që të integroheshin dhe të kontribuonin për shtetin shqiptar dhe krahinën e tyre.

Në qarkun e Libohovës, arsimi ishte lënë në duart e mësuesve grekofonë dhe shkollat private ishin shtuar. Ishin çelur shkolla të reja

⁶² *Po aty*, F. MA, V. 1928, D. 5, fl. 13. Raport i Inspektorisë së Arsimit në Tiranë, mbi shkollat greke, 15 korrik 1928.

⁶³ *Po aty*, F. MPB, V. 1929, D. 206, fl. 3-5. Prefektura e Gjirokastrës drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme, 25 prill 1929.

⁶⁴ *Po aty*.

private greke në Vllaho-Goranxi, Peshkëpi e Sipërme dhe Vodinë. Në zonën e Pogonit po vepronte një grup ilegal që drejtohej nga Dr. Kiqati dhe Dr. Zëri nga Sopiku, i cili drejtonte dhe nxiste zhvillimin e arsimit sipas projekteve dhe udhëzimeve të qeverisë greke dhe të organizatave vorio-epirote. Këta persona, me sa duket, ishin segment i organizatës më të gjerë dhe të fuqishme që ishte krijuar për zhvillimin e shkollave greke në Shqipëri. Ajo përbëhej nga grekë që vepronin brenda dhe jashtë kufirit politik të Shqipërisë. Kjo organizatë po zhvillonte një aktivitet intensiv në zonën e minoritetit. Në krye të kësaj propagande arsimore greke ishin konsullatat greke në Gjirokastrë e në Sarandë, të cilat mbikëqyrnin në fshehtësi shkollat greke të atij qarku. Informacionin ata e merrnin nga mësuesit privatë grekofonë. Ato çdo vit dërgonin në Greqi biografite zyrtare të mësuesve privatë, të plotësuara dhe të vërtetuara me noterë. Përveç biografive të mësuesve privatë, këto konsullata dërgonin të dhëna edhe për emrat, origjinën, gradën dhe sjelljet e mësuesve qeveritarë shqiptarë, me qëllim që t'i korruptonin dhe ata nëpërmjet pagesave.

Aktiviteti i kësaj organizate, sado që po zhvillohej me mjete paqësore, financiare e propagandistike, vlerësohej se paraqiste shumë rreziqe për të ardhmen. Kjo sepse ajo synonte të ndryshonte identitetin e një popullsie të tërë heterogjene në zonën e minoritetit dhe përreth saj (autoritetet shqiptare kishin parasysh se këtu kishte edhe vllahë e shqiptarë) nëpërmjet kultivimit të ndjenjave dhe ideve greke dhe e ushqente atë që të ndjehej si një popullsi e huaj në Shqipëri, duke i hapur shteg provokimit të konflikteve me Greqinë. Pra, veprimtaria e këtij komisioni dhe e politikës greke ishte që të krijonte për grekofonët atë pozitë që kishte pasur dikur elementi grek në Perandorinë Osmane. "Këtë propagandë të zhvilluar me pambuk por të infektuar me mikrobe në dëm të atdheut tonë, shteti nuk duhet ta tolerojë. Ai duhet të luftojë po me ato mjete paqësore por rezultative" - thuhej në raportin e Prokurorisë së Gjyqit Politik. Ajo propozonte këto masa: të pushoheshin nga puna 47 mësues privatë të shkollave grekofone dhe të zëvendësoheshin ata me mësues zyrtarë, të zgjedhur që e dinin gjuhën greke. Më e përshtatshme do të ishte që ata të mos ishin nga prefektura e Gjirokastrës. Këta, duke plotësuar angazhimet që kishte marrë shteti shqiptar ndaj Lidhjes së Kombeve, të aplikonin plotësisht programin zyrtar të atyre shkollave, duke i dhënë mësimet në greqisht dhe në shqip. Ata mësues privatë që do të pushoheshin dhe që dinin gjuhën shqipe mund të transferoheshin në një prefekturë tjetër. Kështu, ata do të largoheshin nga ndikimi i

propagandës greke dhe, nga ana tjetër, Ministria e Arsimit do të përfitonte elemente të vlefshëm, me kulturë për shkollat e Shqipërisë së Mesme e të Veriut. Në qoftë se ata nuk do të pranonin të transferoheshin, do të ngeleshin pa punë dhe "ashtu, si të tjerët që nuk dinin shqip, do të shporreshin vetvetiu në Greqi për të gjetur punë në profesionin e tyre"⁶⁵. Frytet e kësaj mase ishin vërtetuar plotësisht në fshatrat grekofone, ku shërbenin mësues zyrtarë të aftë. Në këto fshatra gjuha shqipe ishte zhvilluar fare mirë dhe disa prej nxënësve kishin vazhduar me sukses shkollat e mesme shqiptare, kur më parë nuk dinin asnjë fjalë shqip. Në raport, sugjerohej emërimi i 47 mësuesve zyrtarë në këto fshatra, shumica e të cilëve të ishin normalistë, ndërsa fillimisht, në se ky numër nuk plotësohej me mësues normalistë, një pakicë prej tyre mund të ishte edhe me një kulturë më inferiore se ajo që kishin aktualisht disa mësues privatë në katundet e Vurgut. Në ligjin ndëshkimor për fajë politike të shtohet një artikull, i cili të sanksiononte se "askush, si person fizik ose person moral, nuk mund të subvencionojë një institut publik ose organet e tij, pa marrë më parë pëlqimin e qeverisë dhe askush nuk mund të pranojë këtë subvencion pa miratimin e saj. Çdo dhuratë ose testament në favor të këtyre institucioneve vihet në zbatim pasi qeveria të ketë dhënë pëlqimin e saj, shkelësit e këtij neni dënoheshin...". Për të konkurruar konviktet greke të Lubivanit, Voshtinës, Filatit, Paramithisë e Korfuzit, të cilët po tërhiqnin nxënësit shqiptarë e grekofonë nga Shqipëria e Jugut sugjerohej çelja sërish e Liceut të Gjirokastrës, tashmë i plotësuar. Kulturës greke mund t'i bënte ballë vetëm një kulturë perëndimore, sepse kultura greke e përgatiste nxënësin vetëm për horizontin apo ambientin e ngushtë grek, kurse kultura perëndimore i çelte atij një horizont veprimi më të gjerë në jetën e tij. Për këtë arsye, Liceu i Gjirokastrës do të preferohej më shumë prej çdo prindi për edukimin e fëmijëve të tij. Nga ana tjetër, për të hyrë në këtë lice, nxënësi duhej të kishte mbaruar mësimet e shkollës fillore në gjuhën shqipe. Kjo do të bënte që grekofonët të detyroheshin, për interesin e tyre, të ndiqnin mësimet fillore edhe në gjuhën shqipe, duke e kufizuar greqishten vetëm në njohjen elementare të saj. Dërgimi i djemve në Liceun e Gjirokastrës do të ishte më i pëlqyeshëm se sa dërgimi për studime jashtë shtetit, sepse ata kështu

⁶⁵ *AQSh*, F. MPB, V. 1930, D. 309, fl. 1-9. Prokuroria e Gjyqit të Posaçëm për Fajë Politike drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 17 qershor 1930.

do të ishin nën kujdesin dhe kontrollin e prindërve. Shkolla profesionale ishte shumë e mirë dhe e dobishme për jetën praktike. Prandaj, edhe nga kjo pikëpamje, ishte e preferueshme çelja e Liceut. Ajo do t'i kushtonte shtetit shqiptar rreth 100.000 fr. ari, por kjo ishte një shumë e përballeshme dhe që ia vlente, pasi do të kishte efekte pozitive⁶⁶.

Në tetor të vitit 1930, prefektura e Gjirokastrës informoi se shkollat greke në komunën e Jergucatit, jo vetëm që po zhvilloheshin e udhëhiqeshin nga organizatat greke, por edhe nga Ministria e Arsimit e Greqisë⁶⁷. Nga ana tjetër, autoritetet e xhandarmërisë së Gjirokastrës informonin se në rajonin pranë postës kufitare të Llongos, ishte zhvilluar një mbledhje e fshehtë, për organizimin e një proteste kundër qeverisë shqiptare dhe dërgimin e një memorandumit tjetër Lidhjes së Kombeve, në të cilin autoritetet shqiptare akuzoheshin se do të ndalonin mësimin e gjuhës greke në shkollë⁶⁸. Edhe pse situata në zonën e minoritetit ishte e qetë, veprimtaria e organizatave vorio-epirote dhe e konsujve grekë i mbanin në një nivel të lartë dyshimet e autoriteteve lokale për qëndrimet e minoritetit grek. Kështu, prefektura e Gjirokastrës tregojë e rezervuar në sugjerimet e saj për rekrutimin e intelektualëve grekofonë në shërbim të administratës shtetërore. Në rrethin e Libohovës, ajo nuk gjente asnjë të tillë si të përshtatshëm, në rrethin e Çamërisë vetëm një, në Përmet 3 veta, ndërsa në Delvinë pesë persona⁶⁹. Por, në anën tjetër, qeveria dhe Mbreti përpiqeshin të jepnin shembullin e tolerancës dhe qëndrimit miqësor ndaj minoriteteve. Më 28 nëntor, Mbreti Zog ua fali dënimin grekofonëve A. Muzina, M. Lici e H. Ikonomidhi, "si dëshmi të simpatisë së tij për minoritetet". Dekreti u përcoll me një letër të Mbretit Zog, në të cilën theksohej: "Qysh me krijimin e Shqipërisë vetësunduese shteti është përpjekur që të mos ketë ndryshime midis bijve të tij. Të gjithë të drejtat që ka një shqiptar ua ka dhënë dhe minoriteteve. Nuk ka përjashtime në funksionet më të larta të tij. Do të ishim të kënaqur sikur edhe kombet e tjerë të vepronin kështu. Ka ardhur koha pra që minoritetet ta dinë se janë

⁶⁶ *Po aty*.

⁶⁷ *Po aty*, fl. 13. Prefektura e Gjirokastrës drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 10 tetor 1930.

⁶⁸ *Po aty*, Fondi MPB, V. 1930, D. 51, fl. 127. Komanda e Xhandarmërisë Delvinë, drejtuar Komandës së Përgjithshme të Xhandarmërisë, 16 shtator 1930.

⁶⁹ *Po aty*, Fondi MPB, V. 1930, D. 51/1, fl. 49. Prefektura e Gjirokastrës drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 20 prill 1931.

bijtë e këtij vendi dhe të sillen me besnikëri e urtësi ndaj këtij shteti. Si dëshmi e simpatisë që kam për minoritetet, këtë herë po i fal të dënuarit e lartpërmendur⁷⁰.

Si përfundim, mund të thuhet se, në këtë periudhë arsimimi i minoritetit grek u zhvillua nën ndikimin e qarqeve nacionaliste greke, të cilat synonin nxitjen e një fryme separatizmi te popullsia greke dhe pengimin e integritit të saj në shtetin shqiptar. Ndërsa, qeveria shqiptare synonte që, duke i qëndruar besnike angazhimeve të marra në Lidhjen e Kombeve për mbrojtjen dhe respektimin e minoriteteve, t'i bënte ata qytetarë luajalë të vendit. Ajo, ndonëse ndërmori disa masa për të frenuar shkeljet ligjore që u vërejtën, nuk ia arriti qëllimit që t'i eliminonte plotësisht ato. Ky dështim do të ndikonte që në vitet e ardhshme të ndërmerrej hapi për shtetëzimin e plotë të arsimit në minoritetin grek.

S u m m a r y

GREEK MINORITY SCHOOLS DURING 1925-1930

The national education and identity of the national minorities have been important problems in the Balkans and Eastern Europe during the past century. The different governments, nonetheless obliged by the Treaties of the League of Nations to respect them, have had the tendency to assimilate these minorities with different means and ways.

The Albanian state because of some specific circumstances and also because its weakness within and in the international arena, the lack of extreme nationalism or chauvinism and the existence of many Albanian populations in the neighboring countries followed a correct policy towards the minorities.

This policy was also demonstrated towards the Greek minority, who was the main minority within Albania. The Greek national education and its identity came consolidating. But, from the other side, between the Albanian state and the Greek minority existed a series of controversies which would be treated in this paper. Concretely, the minority violated the international legal obligation in such issues as the financing of the minority schools; the teaching texts and

⁷⁰ "Pakicat", *Demokratia*, Gjirokastrë, 13 dhjetor 1930.

programs; the lack of teaching of the official language, the political propaganda in the schools etc. The Albanian state was dissatisfied from this activity and tried to discipline the activity of these schools in accordance with its goal to integrate these population, but didn't succeed at the right measure.